

SYLLABUSI

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit		
Titulli i lëndës:	Metodat kërkimore		
Niveli:	Master		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II		
Semestri:	III		
Numri orëve në javë:	3		
Vlera në kredi:	5		
Koha / lokacioni:	USHAF		
Mësimdhënësi i lëndës:			
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës	Lënda përgatit studentët në fushën e kërkimeve shkencore dhe projekteve hulumtuese. Do të njoftohen me konceptet bashkëkohore të metodave kërkimore dhe hulumtues. Do të kenë Informacion të përgjithshëm rreth termave themelore që kanë të bëjnë me pjesët e kërkimit. Po ashtu do të fitojnë njohurit rreth përpilimit të Hipotezave, kufizimet dhe përkufizimet, metoda, mostra, metodat e zgjedhjes së mostrës; grumbullimi i të dhënave dhe analiza e të dhënave. Përdorimin e bibliografisë, fusnotave dhe strukturën standarde shkencore të shkruarit.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është përgatitja e studentëve në fushën e metodave kërkimore-shkencore, që do t'u shërbejë atyre për t'ua lehtësuar përgatitjen e projekteve kërkimore dhe punën kërkimore-shkencore në përgjithësi (gjatë kohës së studimeve, por edhe pas përfundimit të studimeve). Lënda do të fokusohet në metodat e ndryshme të punës kërkimore, njohja e të cilave është parakusht për punë studimore.		
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti duhet të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • njohe në thelb konceptet, metodologjinë dhe strategjitë kërkimore, • kuptojë llojet e ndryshme të të dhënave dhe analizimin e tyre, • shtjellon marrjen e mostrave për strategjinë kërkimore, • zhvillon projektimin e instrumenteve hulumtuese për studim, • zgjedhe metodën e duhur të hulumtimit, • interpreton të gjitha fazat që kanë të bëjnë me hartimin e një punimi kërkimor-shkencor. • zbatoj, aplikoj metodat e duhura kryesisht nga objekti i hulumtimit apo studimit. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike raste studimi	1	15	15

Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin – konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren			
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare në provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Punimi, projektet, prezantimi i punimit, etj	1	10	10
Totali			125

Metodologjia e mësimit (dhe mësuesit)	Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi në shtjellimin e materialit duke marrë rastet studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, prezantimi i studenteve për Raste studimi, Punime seminarik-shkencore, Ese apo Huluntim.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Studenti i nënshtrohet provimit final - test me shkrim/gojë - i cili do të jetë i organizuar me minimum 6 pyetje, të cilat do të jenë të kombinuara me detyra. Pikët e provimit final mbledhen së bashku me pikët e përcaktuara të kriterëve tjerë (si në vazhdim) për vlerësimin përfundimtar,</p> <ul style="list-style-type: none"> • 60 pikë - provimi final, • 10 pike - angazhimi në ligjërata dhe vijueshmëria, • 30 pikë - punimi i studentit dhe diskutimi interaktiv për: Rast studimi, Punimi seminarik-shkencor, Projekt hulumtues, <p>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga të gjitha kriteret e vlerësimit,</p>
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, kompjuteri, projektori, Powerpoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% Teori 40% Praktik duke inkorporuar punimin analitik të studentit i cili mund të jetë: Raste studimi, Punim seminarik-shkencor, Projekt hulumtues,
Literatura	
Literatura bazë	1. Matthews, B. dhe Ross, L., (2010), Metodatat Hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik: Tiranë
Literatura shtesë	1. Shamiq, Midhat, Si shkruhet vepra shkencore, “Logos A”, Shkup, 2006.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Llojet e metodave shkencore
Java e dytë:	Kërkimet bazë. Praktika e kërkimeve
Java e tretë:	Fazat e punës shkencore
Java e katërt:	Veçoritë themelore të metodave shkencore

Java e pestë:	Informacion i përgjithshëm rreth termave themelore që kanë të bëjnë me pjesët e kërkimit.
Java e gjashtë:	Përkufizimi i termave “problem, fjali parashtruese e problemit, nën problem, hipotezë, supozime, kufizime, shembuj”
Java e shtatë:	Veçoritë e faktorëve që na ndihmojnë të përzgjedhim temën e kërkimit
Java e tetë:	Fjalë parashtruese e problemit. Veçoritë që duhet të gjenden në një fjali parashtruese. Nën problemet, hipoteza.
Java e nëntë:	Shqyrtimi i të dhënave. Rëndësia dhe objektivi i kërkimit.
Java e dhjetë:	Hipotezat, kufizimet dhe përkufizimet, metoda, mostra, metodat e zgjedhjes së mostrës; grumbullimi i të dhënave, analiza e të dhënave.
Java e njëmbëdhjetë:	Raportimi i rezultateve të kërkimit. Strukturimi i kopertinës. Paraqitja e faqes dhe përpilimi i bibliografisë në përputhje me rregulloren.
Java e dymbëdhjetë:	Veçoritë e gjuhës shkencore.
Java e trembëdhjetë:	Fusnotat dhe bibliografia.
Java e katërbëdhjetë:	Përcaktimi i burimeve dhe projektimi i kërkimit.
Java e pesëmbëdhjetë	Struktura standarde e te shkruarit, përmbledhje e materialit,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t’i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	